

STATUTI

I SHOQËRISË TREGTARE “Trekoal.al” SHPK

Ligji Nr. 9001, datë 01.02.2017, në respektim të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe Ligjet Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Registrimit”, me cilesine e ortakut te shoqerise, hartoj Statutin per Shoqerine “Trekoal.al” shpk si vijon:

TITULLI I

Neni 1: Ortaket.

Ortakë i vetem i shoqërisë eshte:

Z. Jorgo Kapurani, i biri i Mihalit, i datëlindjes 02.05.1994, lindur në Korçë dhe banues në Korce, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar mbajtës i Kartes se Identitetit Nr.031650848, me datë lëshimi 07.03.2012;

Neni 2: Emri.

Emri i shoqerise eshte “**Trekoal.al** ” **Shpk.** (me poshtë referuar si “Shoqeria”)

Neni 3: Selia e Shoqerise.

3.1 Selia e Shoqerise eshte: Rrugë Kapshtice-Korë, km. i 1, **Dogana Kapshtice, Bilisht.**

3.2 Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj. Për këtë, ajo mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjenci në të gjithë territorin e R.SH., si dhe jashtë saj, në përputhje me ligjet e vendeve ku ato hapen.

Neni 4: Forma ligjore

Shoqeria “**Trekoal.al** ” eshte shoqeri shqiptare dhe eshte krijuar si **shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.**

Neni 5: Kohezgjatja.

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj per nje **periudhe kohore te pakufizuar**. Kohezgjatja e saj mund te shkurtohet me vendim te asamblese se pergjithshme te ortakeve.

Neni 6: Objekti i Shoquerise.

Shoqeria me Përgjegjësi të Kufizuar "**Trekoal.al shpk**", do të ketë për objekt aktiviteti, si më poshtë:

- ❖ **Tregeti me pakice dhe shumice te naftes, benzines dhe gazit si dhe nenprodukteve te tyre;**
- ❖ **Transporti i naftes, benzines dhe gazit si dhe nenprodukteve te tyre;**
- ❖ **Import-Eksport;**
- ❖ **Tregeti per vajra lubrifikante dhe pjese kembimi per makina te te gjitha llojeve;**
- ❖ **Lavazh per automjete;**
- ❖ **Bar-kafe dhe ambiente sherbimi;**
- ❖ **Transport mallrash per vete dhe per llogari te te treteve.**
- ❖ **Si dhe të tjera aktivitete të përgjithshme biznesi.**

TITULLI II

KAPITALI

Neni 7: Kapitali i Shoquerise

7.1 Kapitali fillestari i Shoquerise eshte: **100.000,00 (njeqind mijë) leke**.

7.2 Kapitali eshte i shlyer teresisht. Kapitali eshte i ndare 1 kuote të së njëjtës madhësi me vlerë nominale 100.000 (njemije) leke për çdo kuotë. Themeluesi merr në pronësi të tij kuotat e kapitalit themeltar në përpunje me kontributin e tij.

7.3 Kontributi i ortakut te vetem themelues në kapitalin themeltar është si më poshtë:

Jorgo Kapurni: zotëron 1 pjesë të kapitalit ose 100,00%.

GJITHSEJ **100.000 leke =1 pjesë ose 100.0%**

Neni 8: Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit.

Kapitali i shoquerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 9: Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

TITULLI III

ORGANET E SHOQERISE

Neni 10: Asambleja e Pargjithshme

Organi themelor i Shoqerise eshte Asambleja e Pergjithshme.

Asambleja e Pergjithshme merr vendime per:

- (1) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- (2) Ndryshimet e Statutit;
- (3) Emerimin dhe shkarkimin e administratorit;
- (4) Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel te regjistruar;
- (5) Percaktimin e shperblimeve per administratorin, likujduesin dhe ekspertin kontabel te regjistruar;
- (6) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratori, perfshire perqatitjen e pasqyrave finanziare dhe raporteve te ecurise se veprimtarise;
- (7) Miratimin e pasqyrave finanziare dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;

- (8) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- (9) Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tryre;

(10) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne pretendimet ndaj administartorit;

- (11) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;

(12) Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese,

- (13) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 11: Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Përgjithshme.

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi është shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 12: Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të shokualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të përmendor me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 13: Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;

b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;

c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

ç) përcaktimin e shpërblimeve

d) sambikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asambleës;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 14: Përjashtimi nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

a)vlerësimin e veprimtarisë së tij;

b)shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;

c)ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;

ç) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

TITULLI IV ADMINISTRATORI

Neni 15: Emërimi i administratorit

(1) Asambleja e Përgjithshme ka vendsur si administrator te Shoqerise "Trekoal.al " Shpk:

- Z. Jorgo KAPURANI.

Administratori zgjidhet per nje periudhe **pese vjecare**, me te drejte riemerimi ne pajtim me parashikimet e shkronjes "c" te pikes 1 te Nenit 81 dhe 95 te Ligjit.

Administratori do te organizo dhe menaxhoje te gjithe aktivitetin e Shoqerise.Ai eshte i autorizuar te perfaqesoje Shoqerine ne te gjitha ceshjet qe kane lidhje me te.Te drejtat dhe detyrimet e Administratorit burojne nga Ligji, ky Statut, vendimet e Asamblese se Pergjithshme dhe rregullat e brendshme te administrimit te Shoqerise.

Neni 16: Kompetencat e Administratorit

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojnë shoqerinë tregtare;

c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

d) përgatisinadhe nënshkruajnë bilancin svjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përshtérndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme përmiratim;

e) duhur (d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

f) detyruesh (dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

g) (në lidhje) raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

h) (në lidhje) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

i) (në lidhje) Administratoret janë të detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:

– sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

– shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjeter aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

– pre-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

j) (në lidhje) Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqerinë.

k) (në lidhje) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

l) (në lidhje) Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 17

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo përfajje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, përfshirë përballuar në mënyrë individuale ose

solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

- 1.a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
- 1.b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- 1.c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- 1.d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- 1.d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeventë kërkuan. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
- c) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkuesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KAPITULLI V

VITI FINANCIAR DHE EKSPERTET

Neni 18: Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllt me 31 Dhjetor.

Neni 19 Ekspertet

Eksperti ka per detyre qentë kontrollojetë gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithvejetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar perqatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetori si dhe per raste per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese edorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

TITULLI VI

PRISHJA DHE RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Neni 20: Prishja dhe Likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtarit tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përashtim të rasteve kur ështënisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim përemërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 21:

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

TITULLI VII

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 22:

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te pote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Gjithcka nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete Statut do te rregullohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje te tjera te lidhura me te ne Republiken e Shqiperise.

Neni 23

Mosmarrëveshjet

Per mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

Neni 24:

Ky Statut hyn ne fuqi pas miratimit dhe regjistrimit prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

Neni 25:

Ky Statut përpilohet në 2 (dy) kopje origjinale, me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe. Statuti mbylljet me 25 (njezet e pese) nene.

Ortaku i vetem Shoqerise Tregtare "Trekoal.al"shpk

Jorge KAPURANI

